



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI 6-MUJOR PËR KONSULTIMIN E PROJEKTAKTEVE TË MIRATUARA NË
JANAR – QERSHOR 2026

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë periudhës Janar-Qershor 2026 (këtu e në vijim MSHMS) ka miratuar dhe konsultuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, takimeve dhe tryezave të konsultimit me aktorë jo qeveritarë si dhe aktivitete të tjera konsultative si vijon:

1. Projektligji “Për disa ndryshime në vendimin nr. 769, datë 15.7.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”, të ndryshuar.
2. Projektvendimi “Për Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2026–2030”.
3. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Garancisë Evropiane për fëmijët, 2026–2030”

Indeksi i realizimit të procesit të konsultimit publik për vitin 2026 është 100%, pasi 3 aktet e miratuara i janë nënshtruar të paktën një prej metodave të konsultimit publik, të cilat kanë siguruar pjesmarrjen e palëve të interesit dhe nga ky proces është mundësuar mbledhja e reagimeve dhe komenteve.

Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Garancisë Evropiane për fëmijët, 2026–2030” i është nënshtruar një procesi të zgjeruar konsultimi publik por publikimi i tij në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik është bërë me vonesë.

Vlerësohet se procesi i konsultimit publik për gjashtëmujorin e parë periudhë Janar-Qershor 2026 paraqet një trend të kënaqshëm duke patur parasysh një numër të madh aktorësh të përfshirë, sidomos nga organizata joqeveritare për shkak të ndjeshmërisë në lidhje me çështjet që trajtojnë projektaktet për konsultim.

Takimet konsultative janë zhvilluar nëpërmjet platformave të ndryshme, ndër to tryezat e përbashkëta dhe nëpërmjet e-mailit.

Në takime kanë marrë pjesë aktorë joqeveritarë të profileve të ndryshme si ekspertë të fushës, shoqata dhe organizata ndërkombëtare.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për gjashtëmuajorin e parë periudhën Janar-Qershor 2026, ka konsultuar nëpërmjet takimeve dhe tryezave të konsultimit me aktorë jo qeveritarë si dhe aktivitete të tjera konsultative për 3 akte.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026 (Janar- Qershor) janë miratuar gjithsej 9 akte.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

3 akte nga 9 të miratuara gjithsej, janë objekt i konsultimit publik. Procesi i konsultimit publik është zhvilluar për të 3 aktet.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Projektligji Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, i është nënshtruar procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për vitin 2026 janë planifikuar miratimi i 26 akteve në PPAP. Për 16 prej tyre janë aplikuar kriteret përjashtuese bazuar në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Këto akte bazuar në përcaktimet përjashtuese të ligjit janë të një nga llojet e mëposhtme:

- a) çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
- b) marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrë-veshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe; aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;
- ç) aktet normative, me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave;
- d) emergjencën civile; dh) çështjet e tjera përjashtimore të parashikuara me ligj.

Lidhur me aktet e parashikuara në PKIE 2024 -2026, MSHMS ka planifikuar miratimin e 18 akteve të lidhura me përafrimin e Acquis. Për 9 prej tyre janë aplikuar kriteret përjashtuese.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Struktura e 4 akteve të konsultuara që iu nënshkruan konsultimit publik janë:

- 1 Projektligj
- 2 Projektvendime.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Procesi i Konsultimit Publik për projektaktet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duke e krahasuar me vitin e kaluar paraqet një trend në rritje, duke ju referuar numrit të pjesëmarrësve në konsultimet e projektakteve dhe reagimeve të mbledhura.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Projektaktet e miratuara për periudhën Janar-Qershor 2026 objekt i konsultimit publik, janë konsultuar nëpërmjet metodave të ndryshme të konsultimit. Konkretisht metodatat e përzgjedhura për konsultim publik janë:

- Regjistri Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.
- Posta elektronike;
- Konsultim e këshillim gjatë hartimit të projektaktit të akteve;
- Tryeza të konsultimit publik pas përgatitjes së draftit të akteve.

Metodat e konsultimit nëpërmjet takime konsultative u përdor për të 3 aktet e konsultuara. Publikim në RENJKP për të 3 aktet si dhe komunikime zyrtare dhe me e-mail për të 3 aktet e miratuara për këtë periudhë.

1. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.1009ë, datë 9.ë.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”

Pojektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike në datë 25.02.2026 me qëllim garantimin e përfshirjes në procesin e konsultimit, të të gjithë aktorëve të interesuar. Ky proces ka përfunduar më datë 25.0.2026. Nuk ka patur komente nga grupet e interesit.

2. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-20ë0, u konsultua në mënyrë drejtpërdrejtë dhe online nëpërmjet metodave :

- Takime të rregullta të Grupit Ndërinstitucional të Punës i ngritur me Urdhër Nr.5ë6/2025;
- Anëtarë, përfaqësues të institucioneve në nivel qendror dhe varësisë;
- Konsultimit me përfaqësues dhe persona përgjegjës të zyrave të njësive e vetqeverisjes vendore (61 bashki);
- Konsultimit në takime me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të pakicave rome dhe egjiptiane;
- Publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimin Publik.
- Publikimit në faqen zyrtare të MSHMS të projektaktit
- Konsultim me Këshillin Konsultativ për Vetëqeverisjen Vendore (2ë.04.2026).

Në vijim, MSHMS ka bashkërenduar të gjithë procesin e konsultimit përmes reflektimit të mendimeve dhe kontributeve të dhëna për Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030, duke përgatitur relacionin përfundimtar të projekt-vendimit për miratim në Këshillin e Ministrave.

3. Projektvendimi “Për miratimin e Planit kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030” u konsultua në mënyrë drejtpërdrejtë dhe online me metodat e konsultimit si vijon:

- Takime të rregullta të Grupit Ndërinstitucional të Punës i ngritur me Urdhër nr.
- Takimet me institucionet, institucionet e pavarura
- Takimet me organizatat e/për aftësinë e kufizuar
- Publikimit të Projektaktit më datë 30 Mars 2026, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;
- Publikimit në faqen zyrtare të MSHMS të projektaktit datë 30 Mars 2026 dhe paketës shoqëruese;
- Konsultim në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (4.2026) dhe Këshillin Konsultativ për Vetëqeverisjen Vendore (2.04.2026).

4. Për procesin e konsultimit publik “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026 – 2030, u përdorën metoda si më poshtë:

- Publikimi i projektvendimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik;
- Takime dhe Workshope konsultative të drejtpërdrejta dhe online, të realizuara me:
 - Anëtarë të Grupit të Punës/me Urdhër Ministri
 - Anëtarët shoqërisë civile;

Konsultime në kuadër të Urdhrit të të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 577, datë 8 nëntor 2024, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për ngritjen e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës”.

Konsultime me grupe teknike në secilën ministri përgjegjëse, drejtuar nga Zëvendësministrat e fushës përkatëse

U-report, anketa, fokus grupe për konsultimet me fëmijët (gjatë mbledhjes së nevojave dhe identifikimit të prioriteteve dhe më pas konsultimin e draft planit • Fokus grupe me prindër në bashkitë Vlorë, Vorë, Kukës dhe Korçë.

Takime konsultative me aktorë publike e jo-publike

Mendime/sugjerime të ndara përmes emailit.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metodat e konsultimit që gjeneruan më shumë komente dhe u përfituan mendime dhe kontribute janë: Takimet e drejtpërdrejta, shkresat zyrtare të dërguara nga institucionet anëtare të Grupit të Punës dhe grupet e interesit që për përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane; Personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të fëmijëve.

Gjithashtu, komente dhe sugjerime u morën dhe përmes komunikimeve me postë elektronike, si edhe nga organizatat e shoqërisë civile.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka organizuar konsultime paraprake, me ekspertë të fushës, fokus grupe me palët e interesit dhe takime me me përfaqësues tëë organizatave ndërkombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë në 4 raste.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Për të gjithë projektaktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, për 6 mujorin e parë të vitit 2024, nëpërmjet publikimit në RENJK, është respektuar afatin ligjor prej 20 ditë pune.

2.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit është sipas afateve.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për miratimin e projektaktit “Mbi miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2026-2030” morën pjesë në procesin e konsultimit gjithsej 120 pjesëmarrës, numri i pjesëmarrësve kontribues (aktorëve të jashtëm jo qeveritarë, aktorë të organeve këshillimore apo grupeve të punës të hartimit të dokumenteve politike të miratuara nga qeveria) është 28, detajuar si më poshtë:

Palë të interesit të përfshira:

- a. Grupi Teknik Ndërministror;
- b. Këshilli Konsultativ: Qeverisja Qendrore dhe Vetëqeverisja Vendore;
- c. Institucionet shtetërore dhe ministritë e linjës si: MD, MF, MA, MEI MIE, MPB, AKPA, ASPA, DNJF, etj.;
- d. Organizatat përfaqësuese të Romëve dhe Egjiptianëve si IRCA, Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, Qendra për Advokim Social, Roma Active Albania, TIRC, Voice of Roma, Amarodrom, Qendra T’reja, Vish kepuçet e mia, ACA Albania, Rromano Kham, Levizja Rome dhe Egjiptiane Elbasan, Roma Education Fund,
- e. Partnerë strategjikë;
- f. Institucione të pavaruara.

Pëër miratimin e Planit kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030” morën pjesë në procesin e konsultimit gjithsej 120 pjesëmarrës, numri i pjesëmarrësve kontribues (aktorëve të jashtëm jo qeveritarë, aktorë të organeve këshillimore apo grupeve të punës të hartimit të dokumenteve politike të miratuara nga qeveria) është 28, detajuar si më poshtë:

Palët e interesit të përfshira

- Institucionet shtetërore dhe institucionet e pavarura.
- Qeverisja Vendore
- Partnerët strategjikë.
- Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
- Këshilli Konsultativ për Vetëqeverisjen Vendore.
- Organizatat e personave me aftësi të kufizuara si: MEDPAK, Shoqata Paratetraplegjikë, Shoqata e të Verbërve, ANAD, Fondacioni “Së Bashku”. Fondacioni “Pema e Jetës”, Down Syndrome Albania, Caritas Albania, ADRF, Global Care Albania, TISS, Autizmi Flet, Qendra “Edhe unë mundem”, Shoqata “Ndihmoni Jetën”, Qendra “Lumturo Dhimbjen”, Save the Children, World Vision”, etj.

2.5 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Në procesin e konsultimit publik për vitin 2026 morën pjesë aktorë të jashtëm të tipologjive të tillë si:

- Organizata të shoqërisë civile;
- Organizata ndërkombëtare;
- Ekspertë të pavarur.

2.5.1 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në procesin e konsultimit publik të akteve të miratuara përgjatë vitit 2026, morën pjesë në takime konsultative dhe aktivitete të tjera konsultimi publik, 320 aktorë dhe palë interesi. Nga të cilët dërguan komente dhe reagime 61 aktorë.

2.5.2 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Struktura e kontribuesve:

- Organizata të shoqërisë civile;
- Ekspertë të mundësuar nga UNDP;
- Institucione publike në nivel qendror.

2.5.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata në krahasim me vitet e kaluara paraqitet në rritje, nisur nga numri i madh i aktorëve të jashtëm të përfshirë në procesin e konsultimit publik.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.2. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

- Për miratimin e Planit kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030” numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej nga sugjerimet e bëra janë 19, nga të cilat 10 janë pranuar plotësisht, 5 janë pranuar pjesërisht dhe 2 komente janë refuzuar.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Duke e krahasuar me vitin e kaluar tendenca e komenteve dhe rekomandimeve mbetet në rritje. Referuar numrit të madh të komenteve të ardhura nepërmjet procesit konsultativ, derguar me shkrim në formë shkresore dhe formë elektronike (sistemi elektronik i e-akteve).

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

2.6 **Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

2.6.5. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për aktet e publikuara në RENJK, për të cilat afati i konsultimit është mbyllur dhe është bërë vlerësimi i komenteve nga strukturat teknike, institucioni ka publikuar raportet individuale të konsultimit.

2.6.6. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Nuk ka raporte të papublikuara.

2.7 **Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Indeksi performancës për cilësinë e konsultimit publik është 8 për secilin nga projektaktet e miratuara duke vlerësuar se konsultimi ka ndjekur shumëëllojshmëri metodash konsultimi me një sërë aktorësh publikë dhe jopublikë.

3 **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidë mbetet pjesëmarrja e publikut të gjerë dhe grupeve të interesit me komente në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Sugjerohet një fushatë komunikimi me prioritet të qartë për të rritur dukshmërinë dhe aksesin në këtë regjister. Materialet objekt konsultimi ngarkohen në platformë, por duhet përshtatur aksesin vizual i materialeve pa qenë nevoja e shkarkimit (*download*). Në vijim të rritjes së dukshmërisë, do të duhet nxitja e grupeve të interesit, pjesëmarrës në tryezat e konsultimit publik që të ndajnë informacionin përmes platformave të tyre të komunikimit me qëllim informimin e grupeve të tyre të interesit.

